



Republika e Kosoves
Republican Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 39/15

Prishtinë, më 10.12.2015, ora 11:30

Ndertesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Ne mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Labinote Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Jelena Bontic dhe Bardhyl Meta.

Munguan: Ilir Deda, Enver Hoti dhe Bali Muharremaj dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të ftuar: Agim Krasniqi – Zëvendës Ministër i Financave.

Gjithashtu të pranishëm ishin : Rejhane Zylfiaj nga GIZ.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljeta Krasniqi, Dashurije Canolli, Medina Agushi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i Raporteve me rekomandime të komisioneve tjera të përhershme lidhur me Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, Projektligjin nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-237 dhe Projektligjin nr. 05/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221, nr. 04/L-116 dhe nr. 04/L-194, si dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa;**
3. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendit të ditës**

Kryetari - konstatoi që rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

1. **Shqyrtimi i Raporteve me rekomandime të komisioneve tjera të përhershme lidhur me Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, Projektligjin nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-237 dhe Projektligjin nr. 05/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221, nr. 04/L-116 dhe nr. 04/L-194, si dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa**

Kryetari – sa i përket amendamenteve të Komisionit tonë lidhur me Projektligjin nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-237, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, ka bërë një vërejtje dhe ka dhënë një rekomandim. Më konkretisht, është rekomanduar që në amendamentin 13, fjalët “1. Anëtarët e KRPP-së emërohen në të njëjtën kohë për një mandat prej 5 (pesë) vjetësh, dhe mund të riemërohen vetëm një herë”, të hiqen dhe të zëvendësohen me fjalët “Anëtarët e KRPP-së emërohen për një mandat 5 (pesë) vjeçar pa të drejtë riemërimi”. Një vërejtje e tillë është dhënë vetëm për KRPP, por këtë nuk e kanë potencuar edhe për OSHP-në. Mendojë që nëse e përkrahim këtë rekomandim, ndryshimet e njëjta duhet të bëjmë edhe për anëtarët e OSHP-së.

Safete Hadergjonaj - unë mendojë që nëse përkrahim rekomandimin për KRPP-në, një propozim të tillë do të ishte mirë të propozonim edhe për anëtarët e OSHP-së. Nëse një puntorë është shumë i mirë atëherë dhjetë vite është shumë për të qenë anëtar i bordit. Kishte qenë më mirë me ligj që të bëhet kufizimi deri në pesë vite. Vërtetë në këto borde me qenë në mandat dhjetë vjeçar është shumë.

Besa Gaxherri – unë mendojë që për shkak të eksperiencës, do të duhet që ndonjëri prej tyre të ketë mundësinë për ushtrimin e një mandati të bordit në bazë të procedurave të rregullta ligjore.

Kryetari - natyra e punës së bordeve është e ndryshme. Psh. bordi i AKP është me mandat dy vjeçarë dhe këtij bordi i lejohet të riemërohet. Kemi borde tjera me mandat tre vjeçar dhe është normale nëse i lejohet riemërimi, por bordet me pesë vite mandat unë mendoj që është e arsyshme që të kufizohet me një mandat dhe prandaj ne mundemi që ta pranojmë rekomandimin.

Komisioni njëzëri përkrahu rekomandimet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit për ndryshimet në amendamentin 13, respektivisht në paragrafin 1, fjalët 1. Anëtarët e KRPP-së emërohen në të njëjtën kohë për një mandat prej 5 (pesë) vjetësh, dhe mund të riemërohen vetëm një herë”, zëvendësohen me fjalët “Anëtarët e KRPP-së emërohen për një mandat 5 (pesë) vjeçar pa të drejtë riemërimi”. Teksti në vazhdim mbetet.

Po ashtu Komisioni, njëzëri vendosi që në amendamentin 18, të shtohet teksti si në vijim:

Neni 57, paragrafi 1, riformulohet si vijon:

1. Bordi i OSHP-së përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë që emërohen për një mandat 5 (pesë) vjeçar pa të drejtë riemërimi.

Kryetari – propozojë që të bëhet një riformulim në amendamentin 21, si në vijim:

Neni 102 **Suspendimi dhe largimi i anëtarëve të OSHP-së**

Nëse një anëtar i OSHP-së i nënshtrohet një procedure gjyqësore në të cilën akuzohet për veprë penale lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë në OSHP, suspendohet nga puna. Nëse një anëtar i OSHP-së është dënuar për ndonjë veprë penale lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë në OSHP, largohet nga puna.

Komisioni njëzëri përkrahu propozimet e kryetarit për riformulimin e amendamentit 21, sipas tekstit të lartëshënuar.

Kryetari – njoftoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, kanë bërë dy amendamente dhe tri rekomandime.

Në amandamentin 1 është thënë se pas nenit 9 shtohet neni i ri 10 me tekstin si ne vijim.

Buxheti i ndarë për Zyrën për Komunitete në Zyrën e Kryeministrit, kategoria subvencione dhe transfere dhe buxheti i ndarë për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport, Ministrinë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, Ministrinë për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Ministrinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Ministrinë për Shëndetësi, për projektet kapitale, shfrytëzohet në pajtim me Programin për komunitete të miratuar nga Qeveria.

Kryetari konstatoi se Komisioni me 1 votë Për, pesë Kundër dhe asnjë Abstenim, nuk përkrahu amendamentin 1 të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim.

Kryetari – me amendamentin 2, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka kërkuar që në tekstin e amendamentit 55 të Komisionit Funkcional, shkurtesa “RAE”, të zëvendësohet me emërtim të plotë “Komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian” në gjuhën shqipe. Mendojë që ky amendament është i pranueshëm dhe ne mund ta përkrahim dhe rregullimin e bëjmë në amendamentin 55 që kemi propozuar, duke shkruar emrin e plotë për Komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri përkrahu amendamentin 2 të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, dhe bëri ndryshimet në amendamentin 55 të Komisionit funksional, ku shkurtesa “RAE”, zëvendësohet me emrin “Komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian”.

Kryetari - sa i përket amendamentit 61 të propozuar nga deputeti Çerim Bajrami dhe amendamentit 62 të propozuar nga Deputetët Adem Salihaj, Milazim Haliti, Blerim Grainca, Synavere Rysha, Ali Sadriu, Danush Ademi, komisioni funksional nuk i ka përkrahur, ndërkaq Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve është deklaruar se i përkrah. Unë mendojë që kjo nuk bie në domenin e Komisionin për Komunitete dhe ska të bëjë fare me interesat e komuniteteve, ne nuk e kemi përkrahur dhe mendoj që qendrojm prapa vendimit që e kemi marrur me heret.

Kryetari konstatoi se Komisioni mbetet prapa qëndrimeve për mos përkrahjen e amendamentit 61 dhe 62.

Mbledhja përfundoi në ora 12:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani